



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2876/ 12 prot.

Datë 19/01/2024

**V E N D I M**  
**Nr. 75/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19/01/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1342/2023, datë 20.12.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, Loti 2, me Nr. REF-83167-10-11-2023, me objekt: “Blerje Laborator Levizes (Autolaborator) për Inspektoriatin Shtetërorë Teknik dhe Industrial”, me fond limit 16,166,666 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK me NIPT: J93610823R dhe me adresë: *Rruga “4 Dëshmorët”, nr. 195, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara  
*Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”..

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 20.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1342/2023, datë 20.12.2023, ku vendosi:

[...]

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “MEDFAU” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, Loti 2, me Nr. REF-83167-10-11-2023, me objekt: “Blerje Laborator Levizes (Autolaborator) për Inspektoriatin Shtetërorë Teknik dhe Industrial”, me fond limit 16,166,666 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 1457/7 prot., datë 08.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2867/9 prot., datë 11.01.2024, autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 1342/2023, datë 20.12.2023, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke e anuluar procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, Loti 2, me Nr. REF-83167-10-11-2023, me objekt: “Blerje Laborator Levizes (Autolaborator) për Inspektoriatin Shtetërorë Teknik dhe Industrial”, me fond limit 16,166,666 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

### II

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton**

II.1. Me shkresën nr. 1457/7 prot., datë 08.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2867/9 prot., datë 11.01.2024, autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara, lidhur me

zbatimin e Vendimit Nr. 1342/2023, datë 20.12.2023, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke anuluar procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, Loti 2, me Nr. REF-83167-10-11-2023, me objekt: “*Blerje Laborator Levizes (Autolaborator) për Inspektoriatin Shtetërorë Teknik dhe Industrial*”, me fond limit 16,166,666 (*gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e mësipërme të prokurimit sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr. 1342/2023, datë 20.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*”, Loti 2, me Nr. REF-83167-10-11-2023, me objekt: “*Blerje Laborator Levizes (Autolaborator) për Inspektoriatin Shtetërorë Teknik dhe Industrial*”, me fond limit 16,166,666 (*gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor në rishpalljen e procedurës së prokurimit të reflektojë në dokumentat e tenderit përcaktimet e Vendimit Nr. 1342/2023, datë 20.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të dërgojë këto dokumenta pranë Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

